



**KONTRATË PËR BLERJE KUOTASH**

Në Tiranë, sot më datën 13.12 2005 (dymijë e pesë) para meje Noteres Publike Eriketa KOKOLI, me seli në rrugën "Kont Uran", Nr.20, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, ndërmjet:

- a) **Z. Llazar ANGJELI**, i biri i Sotirit, lindur ne Sarande, më 05/02/1940, banues në Rr. "Durrësit", Pall.124, Shk.2, Ap.15 - Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i pasaportes Nr. Z 085140, (në vazhdim i quajtur "Shitësi").
- b) **Asllan MUHARREMI**, i biri i Ramazanit, lindur me 26.04.1951 ne Fshatin Gure e Madhe – Mat, banues ne Rr."Jordan Misja" Nr.147 Tirane; me pasaporte Nr.Z 0238150, madhor, me zotesi te plote juridke per te vepruar (në vazhdim e quajtur "Blerësi").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. **Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të 25 (njetzet e pese) pjeseve me një vlerë nominale prej njetzet e pesemijë (25,000) Lek.Këto pjese përfaqësojnë 40% të kapitalit të shoqërisë tregtare "ASANLB"shpk.
2. **Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të pjeseve të sipërpërmendura, dhe më saktë të 25 (njetzet e pese) pjeseve me një vlerë nominale prej njetzet e pese mijë (25,000) Lek, që përfaqësojnë 25% të kapitalit të shoqërisë "ASALB"shpk, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre **Blerësit**, i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej prej njetzet e pese mijë (25,000) Lekë. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ashtu dhe në Librin e shoqërisë "ASALB"shpk.
3. **Blerësi** ia ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej njetzet e pese mijë (25,000) Lekë.
4. **Shitësi** deklaron se pjeset transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
5. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre pjeseve.
6. Pas transferimit të pjeseve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto pjese dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar pjeset në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë hartohet në katër (4) origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar dhe kopja e katërt mbahet nga Noteri Publik, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë dhe mbasi deklaruan se e kuptuan e nënshkruajnë rregullisht para meje Noterit.

### PALËT KONTRAKTUESE

**SHITËSI**

Harvan Arifaj,  
G. Q. K.

**BLERËSI**

ASLIM MUHARRERI  
[Signature]



[Signature]  
[Signature]

NOTERE  
ERIKETA KOKOLI

[Signature]

